



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1056/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesuese, Kymete Kicaj dhe Adnan Konoshevi anëtar, duke vendosur lidhur me apelin e Kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrris, Drita Dibrani, nga Subjekti Politik, Levizja Vetvendosje (LVV) dega në Vushtri, paraqitur kundër vendimit me numer 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021 mori kete ;

## V E N D I M

**Hudhet i parregullt apeli** Anr.1056/2021, i datës 04.11.2021, i parashtruar nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrris, Drita Dibrani nga Subjekti Politik Levizja Vetvendosje (LVV) dega në Vushtri kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

## A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, PZAP-i, ka pranuar një apel të parashtruar nga Kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrris Drita Dibrani, nga Subjekti Politik Levizja Vetvendosje (LVV), dega në Vushtri. Në apelin e saj parashtruesja ka theksuar se ka munges te votave dhe se as votat e familjave te sajë nuk i figurojnë ,ne vendvotimin me nr 2706/01R i mungojne 6 vota. dhe kërkon nga PZAP që ta shqyrtoj Apelin dhe të marrë vendim për rinumrimim të votave .Parashtruesja e apelit si dëshmi ka bashkangjitur Deklaratën e dëshmitarve që e kanë votuar dhe numrat personal të tyre.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së apelit gjeti se:

### **Apeli është i parregullt**

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoi se apeli i paraqitur nga Drita Dibrani, është i parregullt, sepse apeli në fjalë nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: *“Personi që e dorëzon apelin duhet të përdorë formularin e gatshëm për apelin”*. Të gjitha apelimet duhet të kenë së paku informacionet vijuese:

- a) emrin, adresën dhe informacionet per kontaktim të personit që e dorëzon apelin
- b) arsyen për dorëzimin e apelimt.

- c) hollësi rreth çfardo dëshmie dhe kopje të çfardo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzimin se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të parashtruesit të apelimt.
- d) vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimt.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëcekur sepse formulari e ankueses fare nuk është nënshkruar nga e njëjta.

Nga arsyet e lartëcekura e në mbështetje të nenit 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.1056/2021 më datën 07.11.2021**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimt të këtij vendimi.